

I/e nderuar,

Ne kuader te projektit te Bankes Boterore EQ FINREP ju lutemi te gjeni bashkengjitur materialet informuese per:

1) Programin e edukimit te vazhdueshem te pergatitur nga ekspertet e Bankes Boterore dhe nga Instituti i Kontabilistëve të Miratuar.

Programi do të lejojë kontabilistët të njihen me praktikat më të mira lidhur me edukimin e vijueshëm dhe modelin e aplikuar nga Instituti i Kontabilistëve të Miratuar, me qëllim njohjen dhe respektimin e një prej kërkesave ligjore për mbajtjen dhe ruajtjen e titullit, në kuadër të procesit të verifikimit ndërmarrë nga Bordi i Mbikqyrjes Publike.

2) Material per Trainimet IFRS

3) Audit Pack for SMEs, një instrument ndihmës teknik për auditimin dhe menaxhimin e riskut, për tu përdorur nga Ekspertët Kontabël dhe ekspertët financiarë të bankave.

EQFINREP (Rritja e Cilësisë së Raportimit Financiar) do të ndërtojë dhe thellojë reformat e arritura në kuadër të **projektit CFREP** (faza e parë e zbatuar), dhe do të mbështesë zbatimin e planit të aktiviteteve kombëtar **CAP (Country Action Plan)** ende të paadresuara. Projekti financohet nga një grant Zvicëran i Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), i administruar nga Banka Boterore me ane të CFRR (Qendra për Reformimin e Raportimit Financiar) dhe e ekzekutuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila ka ngritur një grup për zbatimin e reformave (RIG).

Objektivi i përgjithshëm i zhvillimit të Planit të Veprimit Kombëtar (Country Action Plan) konsiston në përmirësimin, llogaridhënien dhe transparencën në raportimin financiar të korporatave në Shqipëri, në përputhje me praktikat e mira ndërkombëtare, me anë të përafrimit të kornizave ligjore dhe institucionale të vendit me BE - Aquis Communautaire duke patur parasysh aspiratën e Shqipërisë për anëtarësim në BE.

Përfituesit kryesorë të këtij projekti janë Qeveria e Shqipërisë dhe Komiteti Drejtues Kombëtar (National Steering Committee). Projekti ka pasur te beje me aktorë përgjegjës për funksione të ndryshme në kuadër zbatimit të platformës së reformës financiare CFRR në Shqipëri. Të gjithë aktorët kanë shprehur angazhimin e tyre për të patur sukses në rezultatet e projektit. Disa përfitues, kanë qenë të përfshirë më herët edhe përgjatë fazës së parë të **CFREP** si psh. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Bordi i Mbikqyrjes Publike, IEKA, institucionet kryesore të arsimit të kontabilitetit dhe shoqatat profesionale. EQFINREP përveç përfituesve të sipër përmendur përfshin Autoritetin e Taksave, Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare.

Projekti përbëhet nga katër komponentë: 1) Edukimi në kontabilitet ; 2) Monitorimi dhe zbatimi i raportimit financiar dhe auditimit ; 3) Paraqitja dhe publikimi i pasqyrave financiare; 4) Menaxhimi i projektit, koordinimi, vlerësimi dhe ndërgjegjësimi publik .

Rezultatet e pritshme janë : (a) Forcimi i kapacitetit të universiteteve dhe institucioneve profesionale për zbatimin e kurrikulave të kontabilitetit në përputhje me praktikat e mira ndërkombëtare; të kuptuarit dhe zbatimi i standardeve përkatëse të kontabilitetit dhe auditimit nga praktikuesit; (b) Kapaciteti i rritur i Autoritetit Tatimor për të kuptuar më mirë standardet e raportimit financiar dhe për të pajtuar diferencat midis raportimit fiskal dhe raportimit për qëllime të përgjithshme; (c) Përmirësim i kapacitetit të institucionit mbikqyrës të auditimit (Bordi i Mbikqyrjes Publike (BMP) dhe rregullatorëve financiarë në monitorimin dhe zbatimin e cilësisë më të lartë të raportimit financiar, bazuar në SNRF të përgatitur nga institucionet financiare; Rritja e kapacitetit teknik të Bordit Publik të Mbikqyrjes për të udhëhequr dhe mbikqyrur performancën e sistemit të sigurimit të cilësisë për profesionin e auditimit; (d) Përmirësimi i

Kapacitetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të siguruar qasje të besueshme, të shpejtë dhe të thjeshtë për publikun e pasqyrave financiare të subjekteve të korporatave; (e) Përmirësim i kapacitetit të menaxhimit të reformave të Komitetit Drejtues Kombëtar, përgjegjës për mbikëqyrjen e reformave të raportimit financiar dhe Ministrisë së Financave.

Projekti EQ-FINREP vazhdimisht prodhon **produkte në fusha të ndryshme**, si kurrikula universiteti dhe materiale mësimore, në kontabilitet, në raportimin e anës fiskale dhe të standardeve të kontabilitetit, paraqitjen e pasqyrave financiare, përmirësimin e raportimit financiar në industrinë financiare, legjislacionin dhe praktikën e përditësuar në mbikëqyrjen publike etj. Duke pasur parasysh kapacitetet e kufizuara të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe institucioneve të tjera të interesuara, shpërndarja e produkteve të shumta dhe komplekse, rezultat i këtij projekti, tek përdoruesit e përcaktuar, është shumë e vështirë të kryhet në mënyrë efektive.

Bashkimi i shoqërive **EDF Consulting dhe Yunus Social** ka si detyrë mbledhjen e të gjithë dokumentacionit dhe produkteve të ofruara nga projekti EQ-FINREP në fazën të ndryshme, të identifikojë kategoritë e interesit dhe të dërgojë raporte domethënëse e të rëndësishme tek përdoruesit e synuar të identifikuar, pasi këto të dorëzohen nga **Konsulentët** e ndryshëm.

Materialet bashkëngjitur u drejtohen punonjesve të sistemit financiar, ekspertëve kontabël, si dhe kontabilistëve të miratuar për tu përdorur sipas nevojave të grupeve përkatëse.

Ju Faleminderi!